

RREGULLORE E FUNKSIONIMIT TË ZYRËS SË FINANCËS DHE AUDITIT TË BRENDSHËM

1. Në zbatim të nenit 13 të Statutit dhe nenit 19 të Rregullores së AU, në AU është ngritur dhe funksionon si njësi administrative - Zyra e Financës.
2. Mënyra e organizmit dhe funksionimit të kësaj njësie administrative miratohet me Vendim të Bordit të Administrimit.
3. Bordi i Administrimit, në zbatim të pikave 2 dhe 3, të nenit 19 të Rregullores së AU përcakton drejtimet kryesore të veprimtarisë së Zyrës së Financës dhe Auditit të Brendshëm.
4. Zyra e Financës, ka në përbërje të saj dy punonjës, numër i cili është i ndryshueshëm, në përputhje me kërkesat e Institucionit nga Bordi i Administrimit.
5. Zyra e Auditit të Brendshëm ka në përbërje të saj një punonjës, numër i cili është i ndryshueshëm, në përputhje me kërkesat e Institucionit nga Bordi i Administrimit.
6. Marrëdhëniet e punës, së të punësuarve në Zyrën e financës dhe atë të Auditit të Brendshëm, rregullohen në bazë të Kontratës Individuale të Punës, sipas përcaktimit të bërë në pikën e 3, të nenit 19 të Rregullores së AU.
7. Puna në Zyrën e Financës do të konsistojë në:
 - a. Ndjekjen e pagesave dhe detyrimeve të klientëve, regjistrimet dhe rakordimet përkatëse me klientët dhe furnitorët;
 - b. Koordinimin dhe përgatitjen e deklaratave financiare, raporteve të ndryshme analitike, informimeve, etj;
 - c. Regjistrimin e faturave të blerjeve dhe shitjeve, veprimeve bankare dhe hyrje-daljet e arkës, kontrollimin e gjendjes financiare dhe pasurore të shoqërisë sa herë të jetë e nevojshme;
 - d. Përcaktimin e objektivave dhe operacioneve financiare që duhen ndjekur përmirësimin dhe rritjen e rentabilitetit të institucionit;



RREGULLORE E FUNKSIONIMIT TË ZYRËS SË FINANCËS DHE AUDITIT TË BRENDSHËM

- e. Përgatitjen e raporteve të ndryshme financiare mujore apo sipas periudhave të kërkuara, përgatitjen dhe raportimin e Pasqyrave Financiare të Shoqërisë konform Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit.;
 - f. Mbajtjen e korrespondecës me organet tatumore si edhe detyra të tjera të ndryshme brenda zyrës.
8. Funksioni i auditit të brendshëm është një aktivitet i pavarur, objektiv dhe këshillues i themeluar për ngritjen e vlerave dhe përmirësimin e operacioneve të zyrës së Financës.
9. Funksionet dhe operacionet që mbulon audit i brendshëm bëjnë që ai të ndihmojë institucionin në përbushjen e vizionit të tij, misionit, objektivave të tij korrente dhe strategjike duke kontribuar sistematikisht në vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të menaxhimit të riskut, të sistemave të kontrollit të brendshëm dhe proceseve të menaxhimit.
10. Funksioni i auditimit të brendshëm do të ndihmojë për të siguruar që:
- a. Informacioni kryesor finansiar, operacional dhe menaxherial është në përputhje me rregullat si dhe i saktë dhe i besueshëm;
 - b. Veprimet e stafit janë në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi, me politikat e institucionit dhe standardet;
 - c. Burimet e institucionit sigurohen në mënyrë ekonomike, përdoren me efikasitet, si dhe janë të ruajtura mirë;
 - d. Operacionet e punës janë të dokumentuara në përputhje me sistemin e vendosur të Kontrollit të Brendshëm, me rregullat e punës, dhe me standardet e larta të etikës;
 - e. Cilësia e punës si dhe përmirësimi i vijueshëm i saj janë parashikuar në sistemin e kontrollit të brendshëm.
11. Zyra e Financës dhe e Auditit të Brendshëm, mban marrëdhënie të ngushta edhe me njësitë e tjera administrative të AU, në funksion të krijimit, mbështetjes dhe realizimit të një aktiviteti të rregullt ndihmës dhe shërbimi, si dhe administrativ universitar në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore që rregullojnë sistemin e Arsimit të Lartë.



RREGULLORE E FUNKSIONIMIT TË ZYRËS SË FINANCËS DHE AUDITIT TË BRENDSHËM

12. Nëpunësit e Zyrës së Financës dhe Auditit të Brendshëm, përgjigjen çdo herë që është e nevojshme për veprimtarinë e Zyrës që ato drejtojnë përpara Bordit të Administrimit.

Kjo Rregullore hynë në fuqi më 28/12/2016

Kryetar i Bordit të Administrimit

Amanda Vrioni

07

